



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
GJUHË SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_

VENDI \_\_\_\_\_

KOMUNA \_\_\_\_\_


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

**Shifra e veçantë e testit:** 00c9647acc35

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

## UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta**.
- Shkruaj mirë, në mënyrë që shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
- Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
- Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps të thjeshtë grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrahë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e pasaktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrahët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



## TESTI GJUHË SHQIPE

1. Teksti i poshtëshënuar është një tekst joletrar. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë për të treguar se çfarë teksti joletrar është:

*Orët dhe zanat-shtojzovallet.*

*Në gojën e popullit, kur përmenden Zanat dhe Orët, thuhet shtojzovallet që do të thotë shtojua, o Zot, vallet. Zanat dhe Orët janë qenie mitologjike, ndërsa fjala “shtojzovallet” vjen si eufemizëm për Zanat dhe Orët ose për të dyjat së bashku.*

*Vendqëndrimi i tyre ka qenë përgjithësisht mal/bjeshka, prandaj rasa gjinore e malit është identifikim: Zana e Velicikut (Zana e Malit të Velicikut).*

*Për Orët thuhet: Ora e Shalës ose Orët e Dugagjinit dhe Ora e Shtëpisë ose Ora e filanit në kuptimin “përkujdestarja misterioze e krahinës, shtëpisë”. Për këtë arsye mund të arrijmë në përfundimin se funksioni i dallon Zanat prej Orëve. Me fjalë të tjera, Zana është një qenie mitologjike, ndërsa Ora është një Zanë me “detyra” të përcaktuara, ndoshta edhe më të kahershme .*

*Për më tepër Zana është trime, sepse në popull thuhet: filani është trim si Zana, ndërsa ky krahasim zakonisht nuk vjen për Orët. Zana është shumë e bukur, prandaj thuhet: E bukur si Zana.*

*Si Zanat ashtu edhe Orët, pra Shtojzovallet, zotërojnë edhe një fuqi të mistershme: aftësinë për të shituar njerëzit. Zakonisht shitojnë burrat që guxojnë t'i shohin Shtojzovallet të zhveshura tek lahen në dritën e hënës, apo këdo që u trazon vallëzimin e tyre në natyrë.*

- Përshkrues
- Infomues-shpjegues
- Udhëzues

2. Në fjalinë e dhënë më poshtë, ndaji në dy grupe bashkëtingëlloret dhe zanoret që janë përdorur. Shkruaj përgjigjet në vijat më poshtë:

*Mësuesja nuk priti që unë të qetësohesha e më pyeti se çfarë ishte herësi.*

Bashkëtingëlloret \_\_\_\_\_

Zanoret \_\_\_\_\_





3. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Lexo me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe trego çfarë lloji i tekstit është:

Sot është ditëlindja ime.  
Në orën pesë do të bëj një festë.  
Do të më pëlqente të vish edhe ti.  
Mirupafshim, Noeli

- Ftesë
- Kartolinë
- Letër

4. Në vendin bosh më poshtë, shkruaj të gjitha bashkëtingëlloret e shurdhëta të gjuhë shqipe:
- 

5. Lexo fjalinë e dhënë dhe duke ngjyrosur rrethin poshtë fjalës përkatëse, trego ku bie theksi logjik i fjalisë:

Fëmijëve u pëlqen të vizatojnë.

- 
- 
- 

6. Lidh emrin me mbiemrin përkatës:

ëmbëlsirë	e lehtë
qytet	i madh
muzikë	e shijshme
trafik	i çmuar
përgjegjësi	i dendur
mendim	e madhe

7. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Trego kush është autor i romanit “Lugjet e verdha”

- Rexhep Hoxha
- Ibrahim Kadriu
- Agim Deva





8. Shkruaj llojet e gjinisë letrare në vijat përkatëse:

Ngjarja rrëfëhet \_\_\_\_\_

Shprehen ndjesitë \_\_\_\_\_

Ngjarja vihet në skenë \_\_\_\_\_

9. Lexo vargjet e marra nga këngët „Martesa e Halilit“ dhe trego cilën figurë stilitike e ka përdorur autori duke ngjyrosur rrethin përpara përgjigjes së saktë:

Syni i saj si kokrra e qershis  
E ka qerpikun si krahi dallndyshës,  
Ftyra e saj si kuqet molla m’degë  
Hunda ndrejt si kalemi Tushës

Goja vogël si lulja që shpërthen  
Dhamët e bardhë si gurzit e lumit;  
Fill mbas shiut kur po i shndrittë dielli  
Qafa e saj si qafa e pllumit.

- Personifikimi
- Epiteti
- Krahasimi

10. Lexo me vëmendje tekstin e dhënë.

*Këshilla për mbrojtjen e fëmijëve në kohë plazhi.*

*Mos i leni fëmijët të qëndrojnë në diell pas orës 11:00 të paradites. Lyejeni me kremë mbrojtës rreth 30 minuta përpara se të dalin në diell dhe përdoreni atë disa herë gjatë ditës.  
Bëni kujdes me rrymat dhe dallgat e detit. Mos ja ndani asnjëherë sytë fëmijës, sidomos kur lahet.  
Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është ta shoqëroni në breg ose te laheni me të. Kështu ai nuk do të jetë i rrezikuar dhe do të kënaqet më shumë.*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Teksti në fjalë është:

- Lajm
- Udhëzim
- Përshkrim





11. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Në cilën nga fjalët e mëposhtme bie theksi në rrokjen e fundit.

- fole
- furishte
- barishte

12. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë:

Te fjalët: **infirmier**, **piano**, **kamion**, **tryezë**; shkronjat me të zeza janë:

- Diftongje
- Togje zanore

13. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Në fjalinë e mëposhtme, mbiemri **e larta** është mbiemër i nyjshëm apo i panyjshëm.

Po fluturojmë mbi malet **e larta**.

	saktë	pasaktë
Mbiemër i nyjshëm	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Mbiemër i panyjshëm	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

14. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego cila prej këtyre fjalëve është formuar me prapashtesë:

- Përshkruaj
- Rindërtoj
- Arsimitar





15. Teksti i mëposhtëm është marrë nga vepra Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë e Sami Frashërit. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego cilës periudhë i takon kjo vepër.

*Në ka një gjë, për të cilën Shqipëtarët duhet të kujdesenë me të teprë, ajo pa ndryshim është Diturija. Gjithë katundet e gjithë pshatratë a dy tre pshatra t'afërta bashkë duhet të kenë shkolla të para dhe qytetet të kenë nga më shumë se një, pas madhërisë së tyre. Gjithë djemt' e vashatë që më 7 vjeç e gjer më 13 do të jenë të shtrënguarë të venë domosdo në shkollë edhe ata prindërë, që të mos dërgojnë fëmijën në shkollë, do të qërtohen' e të shtrëngohenë t'i dërgojnë fëmijën në shkollë, do të qërtohen' e të shtrëngohenë t'i dërgojnë. Mësimi do të jetë pa nonjë pagesë, edhe të varfëret do t'u epenë edhe fletoretë e karta etj. pa pagesë. Në mes të çdo nënëgastre do të jetë një shkoll' e dytë për djemt edhe një për vajzat. Në mest të çdo gastre do të jenë veç shkollavet të dyta (ryshdije, skolion), edhe të treta (i'dadije, gjimnasion) për djem e për vajza veçan edhe shkolla për mjeshtëri pas vëndit a për bujqësi etj.*

*Në kryeqytet të Shqipërisë, përveç shkollavet të dyta e të treta do të jetë një gjithëmësime (dar-yl-fyunun, panepistimion), një shkollë ushtërije, një për metaletë e për pyjetë, një për bujqësinë edhe shumë shumë të tjera për dituri e për mjeshtëri të veçanta. Më pastaj edhe dy gjithëmësime duhet të hapen: një në Shqipëri të Sipërme e një në të Poshtërmet. Shkoll' e aniërisë duhet të jetë mb'anë të detit, tek të jen' edhe aniat' e luftësë, në Durrësë a në Ujët-të-Ftohtë (afër Vlorësë).*

**Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë – Sami Frashëri**

- Letërsisë së vjetër
- Letërsisë romantike
- Letërsisë moderne
- Letërsisë së sotme





16. Lexo me vëmendje dy tekstet dhe në vendin e zbrazët me vizë, trego cila është e përbashkëta e këtyre dy teksteve:

### Teksti 1

*Kënga e Dhoqinës*

*Ditën e Pashkës në drekë  
Sec u therr një ka në fshat  
Vajta e mora një okë mish  
Dhe e hodha në kusi  
Të mar një kërcu të zi  
Me vrap dola në avlli  
Të më shpiket një stih  
Me vrap m'u hodh në kusi  
Më helmoi djemt e mi  
Nëntë djem e nëntë nuse  
Të nënta me djem në duar  
Nëntë djepe ç'mi përmbuse  
Nëntë paje ç'mi zhurite  
Nëntë dyfekë ç'mi shite!  
Kostandin, të ardhhtë gjëma  
Martove Dhoqinën larg  
Larg e larg mërguar  
Tre male kaptuar!  
Ditën e Pashkës së madhe  
Dhoqina na hidhej valle  
Kostandini u ngrit nga varri  
Rrasa iu bë kalë  
Balta i u bë shalë  
Vrap e vrap te Dhoqina  
"Mirë se erdhe, o im vëlla  
në ke ardhë për të mirë  
të vishem si gjeraqinë;  
në ke ardhë për të keq  
të vishem si kallogre"*

*të vishem si kallogre"  
"Jo, motër, sikundër je"  
I hipi në vithe kalit  
Zoqtë udhës, thoshin:  
"Cili – viu, viu-viu,  
Kush ia bën, ia bën vetiu,  
Kini par'e s'kini parë!  
Shkon një zogëz bishtbardhë  
I vdekuri me të gjallë  
Vete gjer te der' e kishës,  
"Ikë moj Dhoqinë,  
Se kam punë n'ajo dhimë  
Se aty e kam shtëpinë"  
Vate gjer te dera  
Cek-cek në portë  
"Ç'je ti që kërcet në portë?  
Mos je bushtër, a murtajë?  
A mos je zonja murtajë  
Që më hëngre djemt e mi?"  
"Hap, moj nënë, derenë,  
Jam Dhoqin' e vetëme!"  
Me cin'erdhe, moj Dhoqinë?  
"Un' ardhsh, me Kostandinë"  
Ç'Kostandin, moj t'ardhtë gjëma?  
Kostandini i vdekur,  
Ç'bën tre vjet pa tretur?"  
Një në prak e një në derë  
Plasnë si qelqe me verë.*

**Hoshtevë, Zagori**

### Teksti 2

*Kush e solli Doruntinën*

*Në këmbë, para shtratit të saj, Stresi vështrroi një copë herë fytyrën e Doruntinës. Ishte po aq e bukur si atëherë, në mos më tepër, me atë vijën e buzëve që ia bënte ato të rënda dhe të lehta, njëkohësisht.*

- Doruntinë, - i foli ai me zë fare të ulët .... - .... ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo?
- Ajo bëri një "po" me sy. Stresi deshi ta shtynte edhe pak pyetjen që e mundonte, por ajo i doli vetvetiu:
- Po kush të solli?

*Sytë e saj mbetën të palëvizshëm nën vështrimin e tij.*

- Kush të solli, Doruntinë? – përsëriti ai...

*Ajo nuk ia hiqte sytë, me atë boshësi të pashpresë në mes.*

- Ti i the nënës se të solli yt vëlla, Kostandini, apo jo?

*Ajo bëri prap "po" me sy. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmendurisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zgropët...*

**Nga Ismail Kadare**

E përbashkëta e këtyre dy teksteve \_\_\_\_\_

Fjala kyçe është \_\_\_\_\_







17. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego cilës klasë të fjalëve i përkasin fjalët me të zeza.

Sot u ngjitëm lart te kalaja e Rozafës. U ngritëm herët që të shijonim më shumë. Këtu te muri thonë se u muros nusja e vogël. Aty pak më tej vendi është i lagur. Thonë se ende pikon qumështi nënës. Legjenda e Rozafës më trishton shumë, por gjithsesi më pëlqen.

- Emër                                       Mbiemër                                       Përemër  
 Ndajfolje                                       Lidhëza                                       Pasthirmë

18. Emri **princi** në fjalinë e dhënë është në rasën:

*Dallëndyshja e ndihmon princin në realizimin e ëndrrës së tij.*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- emërore                       gjinore                       dhanore                       kallëzore                       rrjedhore

19. Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë. Trego titullin e vjershës dhe autorin e saj.

*Ja, edhe gjyshja në arkëz,  
Kukull e vogël në katërz,  
Është ... dhe prapë s'është e tëra.  
Sikur nuk është si përhera.  
Gjithë karfica, gjilpëra,  
Kapur satenet në kokë,  
Lidhur këpuckat përposh,  
Shami e lule në gjoks,  
Mbyllur kapakët e syve  
(ç'ndjej u shua brenda tyre?)*

*E sheh... dhe të duket heshtja  
Pe gjasme e pe gjasme vdekja.*

*Gjyshja e vogël, e bukur,  
E pastër...  
Në arkëz kukull.*

*Gjithë karfica, gjilpëra,  
Qepur vite të tëra,  
Lidhur kujtime e malle,  
Dhembje, që duken si përrallë.*

*E sheh... dhe të duket heshtja  
Pe gjasme e pe gjasme vdekja.*

	saktë	pasaktë
Kronikë – Frederik Reshpja	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vdekja e Nositit – Lasgush Poradeci	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vdekja e gjyshes – Fatos Arapi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Mbramja – Esad Mekuli	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>





20. Lexo poezinë e poshtëshënuar dhe trego ç' lloj motivi trajton Asdreni në këtë poezi.

*Lulëkuqeja*

*Lulëkuqeja, e mjerë  
asgjekundi s'ka shtëpi,  
e shkon jetën n'arrati,  
ajo s'është si të tjera,  
s'ka stoli !*

*Fushës kodrës del vetiu ,  
verës ngrohet ,dimri ngrin  
vetë shkundet ,vetë mbinë  
e përfshinë*

*Po vec ngjyra e saj si zjarri  
si një yll që xixëllon,  
tëra bota e imiton  
është shënjë për së mbari  
na shikon*

*Ajo ngjyrë n'ato fletë ,  
është shpresa që tregon  
një të ardhme që ëndërron  
është flamuri ynë vetë  
që valon!*

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- peizazhit
- atdhetar-shoqëror
- meditativ



# FAQE E ZBRAZËT



**ИНТЕРФО**

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
GJUHË SHQIPE

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

**NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT**

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

